

# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shkurt



01

## NDRYSHIMET NË LIGJIN 'PËR RININË'. MUNDËSI TË REJA PËR TË RINJTË!

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, prezantoi në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ndryshimet në Ligjin "Për Rininë", të cilat synojnë rritjen e përfshirjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe politikëbërëse. Ky rishikim, i nisur në vitin 2022, ka ardhur si rezultat i konsultimeve me grupet e interesit dhe përfshin forcimin e mekanizmave ligjorë për përfaqësimin e të rinjve në nivel vendor dhe qendror, gjithëpërfshirjen e të rinjve me aftësi të veçanta dhe nga diaspora, si dhe ngritjen e standardeve për shërbimet rinore. Një nga ndryshimet kryesore është bashkëkryesimi i Këshillave Rinorë me të rinjtë, si dhe krijimi i mundësive për mbështetje konkrete përmes programeve kombëtare të praktikave të punës, talenteve rinore dhe nismave komunitare, duke siguruar financime dhe mbështetje për projektet e të rinjve. Ligji i rishikuar synon gjithashtu të harmonizohet me rezolutat e BE-së dhe të lehtësojë qasjen në financime ndërkombëtare për qendrat rinore.



# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shkurt



02

## SHKOLLA DIMËRORE PËR PUNONJËSIT RINORË, FUQIZIM I TË RINJVE DHE KAPACITETEVE LOKALE

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, gjatë edicionit të katërt të Shkollës Dimërore, theksoi rëndësinë e këtij programi në fuqizimin e të rinjve dhe forcimin e kapaciteteve lokale. Këtë vit, punonjësit rinorë nga 61 bashkitë e vendit u trajnuan me metoda inovative për të rritur angazhimin e të rinjve në komunitetet e tyre.

Gjatë kësaj iniciative, të organizuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, u zhvilluan trajnime mbi Ligjin për Rininë dhe ndryshimet e tij, vullnetarizmin si mjet kyç për aktivizim, përdorimin e mjeteve digjitale, komunikimin në epokën moderne dhe rëndësinë e edukimit joformal. Pjesëmarrësit u pajisën me njohuri dhe mjete praktike për të kontribuar në zhvillimin e komuniteteve të tyre dhe për të nxitur pjesëmarrjen aktive të të rinjve në shoqëri.



03

## TUMO BËHET I ARRITSHËM EDHE PËR TË RINJTË E ELBASANIT!

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, prezantoi në Elbasan iniciativën e re që u mundëson të rinjve të këtij qyteti ndjekjen e kurseve të TUMO-s. Gjatë takimit me nxënësit e shkollave "Dhaskal Todri" dhe "Kostandin Kristoforidhi", ministrja njoftoi se, përmes Agjencisë Kombëtare të Rinisë, 50 të rinj të moshës 15-18 vjeç do të mbështeten me transport dy herë në javë për të ndjekur kurset e TUMO në Tiranë. Programi përfshin animacionin, robotikën, dizajnin grafik, prodhimin muzikor dhe fusha të tjera, duke u dhënë të rinjve mundësi për të zhvilluar aftësi konkurruese në tregun global. Iniciativa u prit me entuziazëm nga nxënësit dhe tashmë 50 të rinj kanë filluar të ndjekin kurset e TUMO në Tiranë.

# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shkurt



04

## AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË ZHVILLON SHKËMBIMIN E EKSPERIENCAVE ME TË RINJTË NË MBRETËRINË E BASHKUAR

Agjencia Kombëtare e Rinisë në bashkëpunim me British Council, mbështeti zhvillimin e një vizite studimore në Mbretërinë e Bashkuar, ku të rinjtë e Këshillave Vendorë Rinorë nga Kukësi, Mati, Tropoja, Bulqiza, Dibra, Malësia e Madhe, Elbasani dhe Tirana, së bashku me përfaqësues të shoqërisë civile dhe medias, patën mundësinë të shkëmbejnë praktika mbi përfshirjen rinore në politikëbërje, arsim, punësim dhe migracion.

Gjatë qëndrimit në Edinburg dhe Belfast, pjesëmarrësit zhvilluan takime me organizata rinore dhe Parlamentin Rinor të Irlandës së Veriut, duke marrë modele frymëzuese për forcimin e rolit të të rinjve në Shqipëri. Ky bashkëpunim mes Agjencisë Kombëtare të Rinisë, British Council dhe partnerëve lokalë synon të krijojë më shumë hapësira për të rinjtë në vendimmarrje, si dhe të mbështesë zbatimin e programit Alternative Pathways në tetë bashki në veri të Shqipërisë.

Përmes kësaj nisme, AKR sjell mundësi të reja për të rinjtë shqiptarë, duke i pajisur ata me eksperiencë dhe praktika të suksesshme ndërkombëtare për të ndërtuar një të ardhme më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për brezin e ri.



05

## PROGRAMI "ZËRI YNË, FORCA JONË", FUQIZOJMË TË RINJTË ME AFTËSI NDRYSHË

Projekti "Zëri Ynë, Forca Jonë" ka mbështetur rreth 50 të rinj me nevoja të veçanta nga Durrësi, Elbasani dhe Kamza, duke i ndihmuar të zhvillojnë talentet e tyre dhe të forcojnë vetëpërfaqësimin për të drejtat dhe nevojat e tyre. Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, gjatë vizitës në workshopin e qendrës TISS, vlerësoi punimet artistike të të rinjve, duke i cilësuar si një mënyrë e bukur e shprehjes së botës së tyre të veçantë. Përmes mbështetjes së Agjencisë Kombëtare të Rinisë, ky projekt u ka mundësuar të rinjve jo vetëm të shprehin talentin dhe emocionet e tyre përmes artit, por edhe të zgjerojnë njohuritë mbi të drejtat e tyre dhe të jenë më të zëshëm në institucionet përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
KRYEMINISTRIA  
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shkurt



06

## FËMIJËT ZHVILLOJNË AFTËSITË KRITIKE DHE LOGJIKE PËRMES PROGRAMIT TË KODIMIT NË SHKOLLA

Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, mori pjesë në një orë mësimore të Programit të Kodimit në shkollën 9-vjeçare "Yzberisht", ku fëmijët demonstruan aftësitë e tyre përmes lojës së kodimit. Ministria theksoi se ky program jo vetëm që ndihmon të vegjëlit të zhvillojnë mendimin kritik dhe logjik, por gjithashtu rrit interesin dhe motivimin e tyre për të mësuar. Çdo nivel i përfunduar me sukses i shtyn ata drejt objektivave të rinj, duke ndikuar pozitivisht edhe në lëndë të tjera. Synimi i programit është të forcohet dhe zgjerohet, për të përgatitur brezin e ri për sfidat dhe mundësitë e së ardhmes në botën e teknologjisë.



07

## PROGRAMI I EKIPEVE SPORTIVE ANGAZHON RRETH 12 MIJË NXËNËS NË TË GJITHË VENDIN

Rreth 12 mijë nxënës në mbarë vendin tashmë janë pjesë e Programit të Ekipeve Sportive, i cili po krijon një kulturë të re sportive në shkolla. Gjatë një vizite në shkollën 9-vjeçare "Yzberisht" në Tiranë, Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, vlerësoi ndikimin pozitiv të këtij programi në motivimin e nxënësve dhe zhvillimin e aftësive të tyre sportive.

Programi zbatohet në 291 shkolla, duke përfshirë 826 ekipe sportive në basketboll dhe volejball, me uniforma cilësore dhe trajnime të rregullta. Kjo nismë jo vetëm që forcon përfshirjen e të rinjve në sport, por edhe promovon një mënyrë jetese më të shëndetshme. Qeveria shqiptare vijon të mbështesë sportin si një investim afatgjatë për brezin e ri.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
KRYEMINISTRIA  
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shkurt



08

## PROFESIONISTËT E RINJ TË BE MËSOJNË MË SHUMË MBI POLITIKAT RINORE NË SHQIPËRI

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, zhvilloi një takim me profesionistët e rinj nga vendet e BE, të angazhuar në Procesin e Zgjerimit pranë Komisionit Evropian. Diskutimet u përqendruan në sfidat, mundësitë dhe politikat mbështetëse për të rinjtë shqiptarë, si dhe në ndryshimet në Ligjin "Për Rininë", i cili u ofron atyre mundësi të reja. Ministrja theksoi se, pavarësisht dallimeve kulturore e gjuhësore, të rinjtë shqiptarë dhe ata të BE-së ndajnë të njëjtin vizion për bashkëpunimin dhe zhvillimin, duke punuar çdo ditë për përmbushjen e kapitujve të negociatave me synimin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE deri në vitin 2030.



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
KRUEMINISTRJA  
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT